

VENDIM
Nr.693, datë 24.10.2007

PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT TË PRONËS NR.132 “ISH-REPARTI USHTARAK 8830”, TIRANË, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TE MINISTRIA E BRENDSHME, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMN NR.515, DATË 18.7.2003, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13, 15, shkronja “c” dhe 16 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Prona me numër rendor 132 “Ish-reparti ushtarak 8830”, Yzberisht, Tiranë, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes, sipas vendimit nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilët i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, t’i kalojë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Brendshme.

2. Prona me numër rendor 132 “Ish-reparti ushtarak 8830”, aktualisht shkolla e trupës, me vendndodhje në Yzberisht, Tiranë, të hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, miratuar me vendimin nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave.

3. Ministrisë së Brendshme i ndalohet të ndryshojë destinacionin e përdorimit të pronës të përcaktuar në këtë vendim, si dhe ta tjetërsojë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.

4. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministri i Brendshëm dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



